



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Srahep" Sh.P.K. të datës 23.10.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 18.09.2023 dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar për nevojat e KPSH" me nr. të prokurimit 616-23-9889-1-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Srahep" Sh.P.K. e datës 23.10.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 18.09.2023 dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar për nevojat e KPSH" me nr. të prokurimit 616-23-9889-1-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Srahep" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. **Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.**

Arsyetim

Operatori ekonomik "Srahep" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 23.10.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 18.09.2023 dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me inventar për nevojat e KPSH" me nr. të prokurimit 616-23-9889-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pika 1 - "Autoriteti Kontraktues në lidhje me kërkesën për sqarimin e tenderit nuk na ofron sqarimin edhe përkundër që kërkesën e kemi paraqitur brenda afatit të përcaktuar kohor për sqarimin e dosjes së tenderit dhe Autoriteti Kontraktues është i obliguar që sa më parë të ofroj sqarimet dhe ti njoftoj operatorët ekonomik".

Pika 2 - " Autoriteti Kontraktues ka hequr nga platforma elektronike dosjen e tenderit dhe në vend të saj ka vendosur përshkrimin e çmimit, si pasojë nuk dihet sakt se cilat kushte duhet të plotësohen për të marrë pjesë në tender..."

Pika 3 - "Autoriteti Kontraktues gjithashtu ka vendosur kushte të pjesëmarrjes të cilat janë diskriminuese dhe jo relevante me natyrën e prokurimit në fjalë. Tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale kapaciteti teknik dhe profesional në pikën nr 6 ka paraqitur kërkesën: 6. Autorizimi i prodhuesit apo dilerit dhe Katallogu Broshura origjinale e prodhuesit per Poz.23, 24, 25, 26, 86, 91, 94, 103, 104, 105, 107, 108, 109, 110, 111. Kerkesa qe per pozicione e lartcekura te paraqitet autorizimi i prodhuesit apo dilerit të autorizuar e kufizon shkajshmërisht konkurrencën pasi që e drejton tregun për furnizim të këtyre materialeve vetëm nga një prodhues i parazgjedhur. Gjithashtu nga AK janë paraqitur specifikat teknike të përshtatura pikëpërpikë për një prodhues. Kjo është në kundërshtim me Neni 28 të LPP për arsye të përshtatjes të specifikimeve teknike të produkteve të prodhuesit "Turmed" per pozicionet. 23, 24, 25, 26, 86, 91, 94, 103, 104, 105, 107, 108, 109, 110, 111 nuk është lënë mundësia që të konkurohet me produkte nga prodhuese tjerë".

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësi kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Në këtë kontekst sektori i prokurimit ka kërkuar nga njësi kërkuese që të bëjë vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore. Rrjedhimisht njësi kërkuese ka dërguar përgjigjen sipas të cilës pretendimet ankimore janë të pabazuara në tërësi. Sa i përket pikës nr. 3, nuk qëndron aspak pretendimi ankimor sipas të cilit specifikimet teknike janë përshtatur për njërin apo tjetrin prodhues.

Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësi kërkuese. Për këto arsye është refuzuar si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Përmes pikës nr. 1 pretendohet se parashtruesi ka bërë kërkesë për sqarime ndërsa Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar sqarimet përkatëse. Ky pretendim nuk qëndron pasi që në sistemin e-prokurimi është evidentuar se parashtruesi me datë 16.10.2023 si dhe me datë 18.10.2023 ka parashtruar kërkesa për sqarime ndërsa Autoriteti Kontraktues ka ngarkuar në sistemin e-prokurimi sqarimet përkatëse me datë 31.10.2023. Shih më poshtë dëshmitë nga sistemi e-prokurimi ku mund të shihet se janë ofruar sqarimet nga Autoriteti Kontraktues.


Aneksi 5 KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË


Per: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

DUKE MARRË PARASYSH SE **SRAHEP SH.P.K** (më tej "Operatori Ekonomik"), pas pranimit të dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, beson se nevojiten informacionet shtesë ose informacionet sqaruese si në vijim:

Kerkojme nga AK qe te na informoje se na cfare perqindje lejohet dallimi ne dimensionet tek inventari Medicinal, perkatesisht pozitat 25,26,91,94,103,104,105,107,108,109,110 dhe 111. Duke e ditur qe inventari medicinal nuk prodhohet ne Kosove dhe rrjedhimisht nuk mund te behet "costum made", atere duhet lejohet qe dimensionet dhe specifikat te ndryshojne sa paku +/-10%, ne menyre qe te mundesohet sa me shume pjesemarrja e OE dhe prezantimi i brendeve te ndryshme. Permendyshe kjo qartazi paraqet shkelje dhe eshte ne kundershitim te plate me Nenin 28 te LPP per specifikime teknike.

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj kërkoj marrjen e informacioneve të identifikuara.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri OE:	SRAHEP SH.P.K
Adresa e postës:	Srahep sh.p.k Rr. UÇK pn , . Prishtinë]
Identifikuesi:	
Emri:	Ardian Morina
Pozita:	Drejtor
Ndeshkrimi:	
Data:	18.10.2023
Koha:	



Dokumenti shtojca

31.10.2023 14:58 PERGJIGJA NE KERKESEN SQARUESE.pdf

Hape:

Shqip



Aktiv

Ngarko:

↑ Shqip

↑ Srpski

↑ English



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Prishtinë, 31.10.2023

Nga: Komuna e Prishtinës, Rr. "UÇK" Nr. 2, Prishtinë 10000
Për: "SRAHEP SHPK "

PËRGJIGJE NË KËRKESËN PËR INFORMACIONE SHITESË

Nr1 i prokurimit	616-23-9889-1-1-1
Nr i brendshëm	616 23 180 111

Titulli i prokurimit: "Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së

I nderuar

Faleminderit që keni marrë pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje si "LPP") i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, pastaj me ligjin nr. 05/L-068 si dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës ka pranuar kërkesën tuaj për informacione shtesë të datës 18.10.2023. Pas trajtimit me kujdes të kërkesës tuaj, ju njoftojmë si në vijim.

Informacione Shtesë:

Lidhur me qeshtjen e ngritur nga kompania Srahep SHPK pas analizimit të qeshtjes në fjale konkludojmë që këto dimensione të paraqitura në dosjen e tenderit kanë ardhë si rrjedhojë e pershtateshmerise se hapësirave ekzistuese që i kemi në QKMF Prishtinë me njesite e saj .

Ju falënderojmë për interesimin dhe mirëkuptimin tuaj.

Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, TREPQES NR.2 - PRISHTINE

Nr i prokurimit	616-23-9889-1-1-1
Nr i brendshëm	616 23 180 111

Titulli: Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguronit sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

2. Operatori ekonomik duhet të angazhojë personelin profesional të cilet duhet të ketë kualifikimet shkollore të më poshtme a) Nje dizajner te interierit, b) Nje arkitekt i brendshem dhe dizajn per ambiente c)nje arkitekt (të gjitha me minimum 4 vite pervoja pune)

2. Te deshmoohen me CV, Diplome universitare te noterizuara, kontrate te punes per stafin

Kemi nje pyetje sa perket Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2

Se a llogaritet edhe gjatë studimeve përvoja e punës e dëshmuar me administratën tatimore të Kosovës apo vlenë vetëm pas diplomimit ?

Presim përgjigje sa më shpejt nga ana e Autoritet Kontriktues

Me respekt,

Drejtori i Srahëp sh.p.k

Prishtinë, 16.10.2023



e-mail sraheshpk@gmail.com

Dokumenti shtojca

31.10.2023 15:10 Pergjigjeje ne kerkesen sqaruese 2.pdf

Hape:

Shqip

↓

📅

Aktiv

Ngarko:

↑ Shqip

↑ Srpski

↑ English

Faqe 5 nga 8

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina -Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Prishtinë, 31.10.2023

Nga: Komuna e Prishtinës, Rr. "UÇK" Nr. 2, Prishtinë 10000
Për: "SRAHEP SHPK "

PËRGJIGJE NË KËRKESËN PËR INFORMACIONE SHITESË

Nr i prokurimit	616-23-9889-1-1-1
Nr i brendshëm	616 23 180 111

Titulli i prokurimit: "Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së

I nderuar

Paleminderit që keni marrë pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje si "LPP") i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, pastaj me ligjin nr. 05/L-068 si dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës ka pranuar kërkesën tuaj për informacione shtesë të datës 16.10.2023. Pas trajtimit me kujdes të kërkesës tuaj, ju njoftojmë si në vijim.

Informacione Shtesë:

Duhet pervojë relevante e punes ne fushen perkatese pas diplomimit ne studimet themelore (BA)

Përmes pikës nr. 2 pretendohet se dosja e tenderit nuk është publikuar në sistemin e-prokurimi. As ky pretendim nuk qëndron pasi që dosja e tenderit është e publikuar në platformën e-prokurimi. Shih më poshtë dëshminë nga sistemi eprokurimi.

Dokumenti shtojca

26.09.2023 14:47 26.09.23 Dosja e Tenderit -korrigjuar-.Doc

Hape:

Ngarko:

Dokumenti shtojca

26.09.2023 14:48 B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara (43).Pdf

Hape:

Ngarko:

Faqe 6 nga 8

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

Përmes pikës nr. 3 pretendohet se specifikat teknike të dosjes së tenderit janë përshtatur për prodhuesin të cilin parashtruesi e citon si "Turmed". Duhet cekur se parashtruesi nuk ofron asnjë argument për pretendimin e tij (dmth nuk sqaron pse sipas tij specifikat qenkan përshtatur për një prodhues të caktuar). Fillimisht duhet sqaruar se përmes nenit 28 paragrafit 7 të LPP lejohet mundësia që në raste të caktuara të referoj specifikat teknike të një prodhuesi të caktuar nëse plotësohen kushtet e caktuara me këtë dispozitivë ligjore. Pra kjo çështje nuk është domosdoshmërisht në çdo rast e palejuar. Sidoqoftë për dosjen e tenderit për të cilën po bëhet fjalë, nuk qëndron pretendimi se specifikat teknike janë përshtatur për prodhuesin e ashtuquajtur "turmed". Në fakt termi "turmed" nuk përmendet askund në dosje të tenderit (në asnjë pjesë të saj). Kjo nënkupton që ky pretendim është sajim i plotë i parashtruesit i cili nuk është i bazuar me asnjë argument të vetëm. Për më tepër mënyra si është formuluar pretendimi ankimor është mjaft kontradiktore dhe paradoksale. Kjo për arsye se parashtruesi në njërin anë pretendon se të gjitha specifikat teknike janë përshtatur për një prodhues të vetëm ndërsa në anën tjetër në pretendimin ankimor nuk i përmend të gjitha pozicionet përkatëse mirëpo i potencion vetëm disa prej tyre (duke aluduar që vetëm disa pozicione qenkan të përshtatura). Nëse sipas parashtruesit vetëm disa pozicione janë të përshtatura kjo nënkupton që nuk qenkan të gjitha specifikat teknike të përshtatura dhe ky fakt duke qenë pjesë e formulimit të pretendimit ankimor është kundërthënëses për të mos thënë është kundërrargument për vet parashtruesin (që përtej paradoksit është edhe jo e logjikshme). Në gjithë këtë mes duhet sqaruar një fakt të rëndësishëm. Nëse në operator ekonomik (pa asnjë paragjykim ndaj parashtruesit apo tenderuesve të tjerë) nuk i posedon kapacitetet e nevojshme për të përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit, atëherë ky fakt nuk nënkupton apriori që dosja e tenderit është e përshtatur ose diskriminuese ose e kundërligjshme në cilëndo formë tjetër. Pra fakti që dikush nuk i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit nuk e bën dosjen e tenderit të kundërligjshme mirëpo ofertën e caktuar e bën të papërgjegjshme për atë aktivitet të prokurimit për të cilin bëhet fjalë.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.


Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 31.10.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.